

PLATFORMA KOMBËTARE PËR GRATË SIPËRMARRËSE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Situata e Grave Sipërmarrëse në Republikën e Kosovës

Në Republikën e Kosovës fuqizimi ekonomik për gratë është proces i kushtëzuar mbi burimet në dispozicion, proces i cili nuk i jep shumë mundësi dhe hapsirë grave që të përdorin aftësit e tyre në mënyrë që të kenë qasje dhe kontroll mbi përfitimet ekonomike. Edhe sot pas trembëdhjetë vjetë të ndihmës për zhvillim, gratë e Kosovës e në veçanti gratë që banojnë në zonat rurale janë ende të marginalizuara dhe kanë relativisht qasje të kufizuar në informata dhe burime. Gratë edhe sot përballen me shumë pengesa në lidhje me rolet tradicionale gjinore që ndikojnë në mundësitë e tyre ekonomike. Mungesa e pronës, mungesa e burimeve financiare dhe mungesa e mbështetjes së qeverisë janë faktor të rëndësishëm që pengojnë zhvillimin e sipërmarrjes më të theksuar të grave.

Kosova ende nuk disponon me një vizion afatgjatë të politikave të qëndrueshme për të mbyllur hendekun në mes të pjesëmarrjes së grave dhe burimeve në veprimtarinë sipërmarrëse. Institucionet qeveritare dhe jo qeveritare të vendit mendohet se punojnë vazhdimisht për të ndryshuar sistemin e vlerave, sjelljeve dhe ambientit nga të cilat varet zhvillimi i veprimtarisë sipërmarrëse të grave, mirëpo në takimet e shpeshta me gratë gjithmonë identifikohen pengesa të shumta për sipërmarrësinë e gruas, nga stereotipet që ekzistojnë në shoqëri deri te mungesa e burimeve financiare dhe mungesa e përkrahjes institucionale.

Gratë jo gjithmonë janë prezente dhe të përfshira në të gjitha agjendat e qeverisë si në nivel lokal ashtu edhe atë qendror. Kjo ndodhë për arsye se mungon një dialog i strukturuar midis palëve kyçe të interesit, mungojnë mekanizmat për mbështetje institucionale për promovimin e politikave dhe ndërmarrjen e masave për gratë, mungojnë mekanizmat për zbatimin e strategjive dhe planeve për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos mekanizmat lidhur me moszbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore. Këto janë vetëm disa nga faktorët që e tregojnë këtë realitet, sepse nuk ekziston mbështetje e posaçme financiare për gratë, kur dihet se qasja në financa është një faktor kritik mundësues për zhvillim dhe fuqizim ekonomik të tyre. Ligjet dhe nën-ligjet fiskale nuk kanë dispozita të posaçme për nxitjen e grave në vetëpunësim. Mungon baza e të dhënave të përhershme për gratë sipërmarrëse në Kosovë dhe aktiviteteteve me të cilat ato udhëheqin dhe menaxhojnë.

Deri më tani është konsideruar se në mesin e pronareve të biznesit të Kosovës vetëm 6 përqind janë femra, mirëpo sipas të dhënave të MTI në vitin 2012, numri i bizneseve në pronësi të grave është rritur për 10 përqind. Ndërsa për gratë sipërmarrëse në Agrokulturë, sipas të dhënave nga MBPZHR, konsiderohet se numri i grave përfituese nga skemat e granteve dhe subvencioneve për vitin 2012, është rritur në 155 gra përfituese, ndërsa pritet që numri i tyre të rritet edhe më shumë në vitet në vijim. Nga 1440 biznese në pronësi të grave (SHE-ERA - Shoqata Afariste e Gruas), tregohet se vetëm 4 përqind e grave kryejnë veprimtari formale në fushën e bujqësisë, 15 përqind e tyre merren me prodhim dhe përpunim, 38 përqind e grave ushtrojnë biznes shërbyes dhe 43 përqind merren me tregti. Një problem i veçantë për gratë është qasja e kufizuar në pronë, të drejtat pronësore dhe trashëgimia ku konsiderohet se vetëm 8 përqind e pasurive të patundshme është në pronësi të grave duke shkaktuar probleme në

sigurimin e kolateralit në tregjet financiare dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të grave. Problemi i pronës në trashëgimi dhe pronësi e bën pothuajse të pamundur ose shumë të vështirë për gratë sipërmarrëse që të marrin kredi (hua) nga bankat, agjencionet qeveritare për zhvillim. ***E gjithë kjo situatë mund të ndryshojë me politikat e duhura të përpiluara në mënyrë që të merret parasysh potenciali i sipërmarrësisë së grave.***

Platforma Kombëtare e Grave Sipërmarrëse

Platforma kombëtare - është grup joformal që vepron mbi baza vullnetare. Këtu punojnë njerëz aktivë të shoqërisë civile për zhvillimin dhe promovimin e grave sipërmarrëse në Republikën e Kosovës, si dhe eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit gjinor.

Platforma u krijua në bazë të Aktit të Biznesit të Vogël (Treguesit e Grave Sipërmarrëse të Stambollit) për rekomandimet e Evropës, Parimet e Prishtinës – Fuqizimi Ekonomik i Grave (Samiti Presdencial i Republikës të Kosovës), Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (2012-2020), "Ligji mbi Barazin Gjinore mes Grave dhe Burrave", Plani Kombëtar në Veprim për Barazi Gjinore, Plani në Veprim për Gratë Sipërmarrëse në Kosovë, si dhe Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Llojeve të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW).

Parimet e Prishtinës dhe Treguesit e Grave Sipërmarrëse të Stambollit (ABV), konsiderohen të rëndësishëm për një zhvillim strategjik për sipërmarrësin e grave dhe përqendrohen në katër fusha: politikat, trajnimet, qasje në burimet financiare dhe rrejtëzim. Ashtu sikurse vendet e rajonit edhe qeveria e Kosovës, përkatësisht ministrit e tyre përkatëse, institucionet që e përkrahin sektorin privat dhe grupet e interesit të qytetarëve duhet të ndryshojnë politikat e tyre në mënyrë që të merret parasysh potenciali i grave duke krijuar një mjedis të favorshëm për sipërmarrësin e tyre.

Platforma e grave sipërmarrëse në Kosovë, është instrument modern dhe efektiv për të gjetur zgjidhjet e detyrave komplekse dhe masive dhe ka këto avantazhe:

- Lejon të marrë në konsideratë interesat e të gjithë pjesëmarrësve të shoqërisë civile, të interesuar në zhvillimin e sipërmarrjeve të grave në Kosovë, zhvillimin dhe realizimin e veprimeve komplekse për përmirësimin e kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit të grave,
- Ndërton një bazë për zhvillimin e dialogut publiko-privatë dhe krijimin e partneritetit,
- Ofron reduktimin e barrierave që përballen gratë sipërmarrëse dhe përmirësimin e klimës së të bërit biznes;
- Promovon rritje të qëndrueshme dhe cilësore të ekonomisë dhe të cilësisë së jetës të qytetarëve.

Grupi jo formal do të jetë në gjendje për të arritur qëllimet dhe objektivat e Platformës, si dhe ka nevojë që të sigurohet përfshirje e përbashkët dhe pjesëmarrje e të gjithë aktorëve të interesuar:

- Shoqatat e Biznesit, organizatat jo-fitimprurëse, jo-qeveritare, organizatat të orientuara për çështjet gjinore, dhe të gjithë ata që përfaqësojnë interesat e grave sipërmarrëse;
- ofruesit e shërbimeve të biznesit, për të cilët një nga grupet e synuara janë gratë sipërmarrëse;

- Dhomat e Tregtisë dhe zyrat rajonale të saj;
- Institucionet akademike dhe institucionet e tjera publike që kanë për qëllim të promovojn zhvillimin e sipërmarrësisë të grave në vend.

Vizioni për të ardhmen e grave sipërmarrëse në Republikën e Kosovës

Ne e shohim një të ardhme e cila do të mundësojë të drejta dhe pjesëmarrje të barabartë të grave, për të siguruar udhëheqjen dhe frymëzimin për të vepruar si një kanal në transformimin e rolit të grave sipërmarrëse së një forcë dinamike e shoqërisë Kosovare.

E ardhmja e grave sipërmarrëse në Republikën e Kosovës do të thotë rritje të pjesëmarrjes së grave, duke integruar gratë sipërmarrëse në komitetet e konsultimit, bordet vendimmarrëse, forume të tjera që lejojnë gratë sipërmarrëse nga të gjithë sektorët dhe organizatat për të kontribuar në përmirësimin e strategjive dhe programeve të elaboruara nga agjencitë qeveritare të lidhura me zhvillimin ekonomik.

Qëllimi kryesor i Platformës është promovimi i grave sipërmarrëse të Republikës së Kosovës përmes partneritetit publik dhe privat.

Objektivi i përgjithshëm: Fuqizimi ekonomik i gruas ku aktor kryesorë për rritjen ekonomike konsiderojmë partneritetin publik-privat, barazin gjinore, krijimin e rrjeteve sipërmarrëse dhe Shoqatave të biznesit.

Objektivat:

- Platforma do të ketë një sistem efikas ligjor, e cila do të luftojë kundër korrupsionit dhe burokracisë dhe politikave diskriminuese që vijnë nga biznesi i madh dhe e ngulfatin biznesin e vogël.
- Të drejtat pronësore do të mbrohen, nuk do të ketë diskriminime kundër sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë sipërmarrjet e grave.
- Praktikrat diskriminuese do të eliminohen në lidhje me gratë sipërmarrëse që kanë të bëjnë me arsimimin dhe trajnimin, si dhe punësimin dhe pagat.
- Qasje e barabartë e grave në zhvillimin profesional në vendin e punës do të sigurohet si dhe mundësi për të ndryshuar profesionin, për të marrë këshilla dhe vendosja e shërbimeve të cilat nuk do të jenë të kufizuara në zonat tradicionale të ofertave të punës.
- Sistemet e informimit do të përdoren në një shkallë të madhe nga gratë sipërmarrëse dhe do të sigurohet qasje e barabartë për gratë e biznesit në zonat urbane dhe rurale.

Lidhur me objektivat e deklaruar, disa çështje do të zgjidhen si rezultat i arritjeve të tyre kryesisht në:

- Zbatimin në praktikë të programeve të veçanta për gratë sipërmarrëse bazuar në ***“Principet e Prishtinës”*** dhe infrastrukturën mbështetëse të biznesit në Republikën e Kosovës;

- Zhvillimin e praktikës financiare dhe kreditore për të mbështetur sipërmarrjen e grave përmes mikro-kredive, zhvillimin e linjave të veçanta kreditore përmes fondeve garantuese nga qeveria e Republikës së Kosovës;

- Zhvillimin e shërbimeve arsimore dhe këshillat për gratë e papuna dhe sipërmarrësve të reja duke përdorur aftësitë e këshilltarëve të qeverisë dhe të shoqërisë civile;

- Koordinimi dhe konsolidimi i burimeve të informatave në dispozicion në nivel qeveritar dhe OJQ-ve, duke ofruar mbështetje për gratë sipërmarrëse;

- Zhvillimin dhe forcimin e potencialit ekonomik të rrjetit të grave sipërmarrëse dhe rrjetit të shoqatave të biznesit.

Drejtimet kryesore për zhvillimin e sipërmarrësisë të grave në Republikën e Kosovës:

Zhvillimi i grave sipërmarrëse duhet të përqendrohet në veprimet shumë mirë të përcaktuara, si dhe zbatimin e programeve të veçanta. Hapi i parë do të jetë zhvillimi që ka për qëllim të kapërcej pengesat dhe programet e mundshme, të cilat dëshmojnë një hendek midis qëndrimit të grave sipërmarrëse dhe realitetit:

1. Për të nxitur strukturat shtetërore në zhvillimin e legjislacionit dhe dokumenteve të politikave ekonomike që synojnë të krijojnë kushte të barabarta për zhvillimin e sipërmarrësisë të grave.

2. Për të hartuar strategjinë në nivel kombëtar për gratë sipërmarrëse në Republikën e Kosovës.

3. Për të inkurajuar pavarësinë ekonomike të grave si një kusht për zhvillimin e mëtejshëm të grave sipërmarrëse nëpërmjet zhvillimit të mbështetjes financiare dhe kredive financiare për gratë sipërmarrëse, zhvillimin e sistemit të fondeve garantuese përmes linjave të veçanta kreditore dhe qasje të grave në të gjitha llojet e burimeve.

4. Për të nxitur trajnimet e grave në aftësitë e biznesit, teknologjitë e reja, punës me internet dhe të përmirësojë kualifikimet e grave sipërmarrëse nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve dhe shërbimeve të konsulencës me ndihmën e qeverisë dhe organizatave jo-qeveritare.

5. Për të zhvilluar rrjete të sipërmarrësisë dhe shoqatave të grave në biznes, krijimin e partneritetit të tyre me institucionet qeveritare dhe private.

Kjo platformë do të ndihmojë në zgjidhjen e një pjesë të problemeve të pranishme dhe do të ndihmojë në tejkalimin e pengesave për zhvillimin e sipërmarrësisë të grave, si dhe eliminimin e çdo forme të diskriminimit gjinor. Gjithashtu, ky dokument do të synojë përmirësimin e marrëveshjeve kryesore që lidhen me zhvillimin e biznesit në vendin tonë.

Ne, pjesëmarrësit e Platformës, jemi të gatshëm të bëhemi partnerë të plotë me pushtetin për të ndërtuar të ardhmen për një Kosovë Demokratike dhe të barabart me vendet tjera Evropiane.